



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 54/ Prot.

Tiranë, më 24.02.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 24.02.2020 ditë e hënë, ora 11.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahim
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Sandër Beci
9. Esmeralda Keshi
10. Vate Staka
11. Besnik Cani

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

- Sekretari i Përgjithshëm

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z.Gent Ibrahim, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të



Drejtësisë” i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kuorumin, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datës 05.02.2020 dhe 11.02.2020 të Këshillit.
2. Miratimi i raporteve për analizimin e aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit:
 - Enrik Haxhija
 - Alketa Zifla
 - Abaz Muça
 - Bledar Maksuti
 - Marjeta Zaimi
 - Adriano Dyrmishi
 - Rozeta Qirjaqi
3. Miratimi i projekt vendimit për caktimin e përkohshëm të një prokurori në pozicionin e prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Miratimi i projekt vendimit për caktimin e përkohshëm të një prokurori në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
5. Miratimi i projektvendimit për caktimin e përkohshëm të prokurorit Julian Çafka në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.
6. Miratimi i projekt vendimit për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm të prokurorit Françesk Ganaj si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.
7. Prezantimi i opinioneve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për t`u komanduar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. (Kabineti i Inspektorit).
8. Prezantimi i opinioneve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për t`u komanduar në pozicionin Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
9. Miratimi i projekt vendimit për fillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë në sistemin e prokurorisë.
10. Miratimi i projekt vendimit për fillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë shprehur interesin për t`u komanduar si inspektor në ILD.
11. Miratimi i projekt vendimit për shtyrjen e afatit të aplikimit për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve vakante si prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (këtej e tutje Prokuroria e Posaçme).
12. Miratimi i projekt vendimit për fillimin e procedurave të komandimit të një magjistrati prokuror pranë EUROJUST për një periudhë 30 mujore.
13. Të tjera, (hedhja e shortit për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të cilët do të jenë pjesë e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, bazuar në nenin 11 të Rregullores).



Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Znj. Seiti merr fjalën. Znj. Seiti u shpreh lidhur me raportet e hartuara nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përsa i përket vlerësimit profesional të prokurorëve subjekt të procesit të vetingut, meqenëse janë voluminoze dhe Komisioni ka arritur në konkluzion pas një shqyrtimi të hollësishëm, Këshillit t'i shtrohen për miratim. Gjithashtu dhe përsa i përket opinionëve për kandidatët që kanë shprehur pëlqimin për tu komanduar në KLP me miratimin e opinionëve për secilin, të kalohet në votim nga Këshilli në të njëjtën seancë.

Z.Ibrahimi merr fjalën dhe sqaron dhe një herë hapat që ndërmerren në procedurën e komandimit të magistratëve pranë Këshillit duke ju referuar neneve 53,54,55 të ligjit për statusin. Ai sqaron që në rastin e Këshillit mqs është organ kolegjal, miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore Këshilli ta miratojë në të njëjtën seancë kur miratohen dhe opinionet .

Më pas Kryetari parashtron propozimin për përfshirjen në rend të ditës të pikës si më poshtë:

1. Në vendimin e Këshillit të miratuar më parë për caktimin e limitit të karburantit në dispozicion të anëtarëve, të bëhet një ndryshim duke zëvendësuar togfjalëshin “limit mujor” me togfjalëshin “sasi mujore”,

Z. Ibrahimi hedh në votim përfshirjen e kësaj pike në rend të ditës

Miratohet unanimisht.

1. **Z. Sheshi** propozon që, për pikën e dytë të rendit të ditës, me qëllim racionalizimin e diskutimit, Këshilli të mos zgjatet në parashtrimin e raporteve që Komisioni ka përgatitur, pasi anëtarët janë njohur me materialin për 7 subjektet e rivlerësimit, por të lexohet vetëm projektvendimi dhe Këshilli të shkojë në votim.

Z. Ibrahimi hedh në votim këtë propozim

Miratohet unanimisht.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datës 05.02.2020 dhe 11.02.2020 të Këshillit.*

Z. Balla shprehet se, procesverbalet janë duke u përmirësuar dhe përveç disa gabimeve ortografike, është bërë një punë e mirë.

Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e tyre

Miratohen unanimisht.



Z. Ibrahimi vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

➤ *Miratimin e raporteve për analizimin e aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit:*

Z. Ibrahimi lexon vendimin e parë të plotë për miratimin e raportit për rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, ndërsa raportet e tjera i shtron për votim. Bazuar në nenet 149/4, 179/b, nenin e të aneksit të Kushtetutës, nenin 189 pika 1, gërma a, të ligjit nr.115/2016 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 40 dhe 42, të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neneve 71, 94 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Këshilli pasi u njoh me raportin e rivlerësimit nga Komisioni i Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për subjektet e sipërcituara, vendosi miratimin e raporteve përkatëse. Një kopje e këtij vendimi, i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e 7 raporteve:

- Enrik Haxhija
- Alketa Zifla
- Abaz Muça
- Bledar Maksuti
- Marjeta Zaimi
- Adriano Dyeremishi
- Rozeta Qirjaqi

Miratohen me 10 vota pro, mungon z. Staka i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Z. Ibrahimi vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

➤ *Miratimin e projekt vendimit për caktimin e përkohshëm të një prokurori në pozicionin e prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Korçë.*

Z. Ibrahimi i kalon fjalën z. Beci të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relaton për relacionet që ky komision ka përgatitur dhe paraqitur Këshillit, në lidhje me propozimin për caktimin e znj.Ollga Visi, prokurore ,propozim i ardhur nga z. Beluri. Z. Beci bën një përmbledhje të situatës juridike në të cilën ndodhet Prokuroria e Korçës. Si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar, KLP për të plotësuar vendin e lirë përkohësisht, ka marrë vendimin për caktimin në pozicion të përkohshëm në pozicionin të znj. Irena Cunoti, nga



prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, si prokurore pranë Gjykatës së Apelit, Korçë. Kjo prokurore ka konsumuar 4 caktimet e përkohshme. Në kushtet që, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, në përfundim të këtij afati mbetet vetëm me 1 prokuror, referuar dhe ngarkesës së punës, në kushtet që dhe Regullorja për ngritjen në detyrë dhe ajo e lëvizjes paralele, nuk janë miratuar ende, është emergjente plotësimi i këtij pozicioni. Citon bazën ligjore: nenin 59, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtaëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, duke i kujtuar Këshillit që, në të njëjtën ditë, në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit i përfundon afati dhe i znj. Rozeta Qirjaqi. Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë dy akte:

1. Caktimin e znj. Ollga Visi në pozicionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë,
2. Caktimin e përkohshëm të saj në pozicionin e Drejtueses së kësaj prokurorie, duke filluar që nga data 24.02.2020.

Ndaj kësaj prokurore nuk ka masa disiplinore, ka përvojë si zv/drejtues, si dhe nga komunikimet me drejtuesin e Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, nuk ndikon në funksionimin normal të kësaj prokurorie. Plotëson kushtet sipas ligjit të sipërcituar. Citon bazën ligjore: nenin 47 pika 6, neni 59, pika 1, 4 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe Rregulloren për Caktimin e Përkohshëm të Këshillit, datë 15.04.2019. Komisioni i propozon Këshillit miratimin e projektvendimeve për propozimet më lartë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Znj. Seiti shprehet se, nuk i duket i arsyeshëm emërimi i znj. Visi në pozicionin e Drejtueses, me argumentin që, nuk është plotësuar kushti ligjor, i panegociueshëm, siç është plotësimi i viteve pranë Prokurorisë ku kjo prokurore do të caktohet si Drejtuese. Argumenton se në këtë mënyrë, duke mos patur përvojën e duhur, Këshilli nuk po merr në konsiderat një kusht të panegociueshëm sic është përvoja, vitet në të njëjtën prokurori. Mbështet propozimin e z. Canit për një ndryshim në Rregulloren e Këshillit. Në përfundim të diskutimit, shprehet se, nuk është dakord parimisht, jo për prokuroren si individ.

Z. Cani e shikon problemin nga këndvështrimi i një prokurori. Fillimisht i shtron pyetjen KZHK, nëse ka vende vakante në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Z. Beci përgjigjet që nuk ka. Z. Cani vazhdon diskutimin dhe e gjykon si problematike faktin që një prokurori i cili është njohur me dosjet të largohet për një periudhë qoftë dhe të përkohshme. Një lëvizje e tillë do të cënonte interesin dhe ecurinë e punës së prokurorisë. Propozon, variantin deri më 5 caktime të përkohshme, duke bërë një ndryshim në Rregulloren për Caktimin e Përkohshëm të Këshillit, neni 3, pika 3 të saj.



Z. Dollapaj shprehet se, këto diskutime Komisioni i ka patur dhe në mbledhjet informale të tij, por sqaron se, kjo situatë e krijuar nuk është për faj të Këshillit. Thekson që, kjo është vetëm një zgjidhje e përkohshme, e detyruar nga rrethanat, në kushtet kur nuk është miratuar ende Rregullorja për ngritjen në detyre dhe ajo për lëvizjen paralele, Komisioni mendoi që këtë moment administrativ, ta rregullojë në këtë mënyrë. Përveç kësaj, prokurorja Ollga Visi, i plotëson kriteret ligjore për të qënë Drejtuese, ajo ka rreth 34 vjet që ushtron detyrën e prokurores.

Z. Bazaj shprehet se i mirëkupton kolegët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, por argumenton qëndrimin e tij kundër, me faktin se nuk mundet që një Rregullore të prevalojë mbi ligjin dhe nuk mundet që një prokurore që nuk përmbush vitet të kalojë nga shkalla e parë në atë të Apelit.

Z. Beluri shprehet se, Komisioni pasi shqyrtoi të gjitha variantet në mbledhjet informale, arriti në variantin që ia parashtrori Këshillit në këtë mbledhje plenare. Argumenton që, nuk do të ishte zgjidhja e duhur, që në pozicionin e Drejtuesit të caktohej jashtë vullnetit të tij, një prokuror nga rrethet, ndërkohë meqë Këshilli është duke përgatitur Rregulloren për ngritjen në detyre dhe atë për lëvizjet paralele, kjo ishte e vetmja zgjidhje. Përfundon diskutimin e tij, duke theksuar që nga komunikimi që ky Komision ka bërë me Drejtuesin e Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, garanton që ky caktim nuk cënon funksionimin normal të prokurorisë në fjalë.

Z. Ibrahim rithekson që Këshilli i ka shqyrtuar të gjitha opsionet: 1. Lëvizja e një prokurori nga një zyrë nga një Prokurori të Gjykatës së Apelit të një rrethi tjetër, në drejtim të Korçës. 2. Ndryshimi i Rregullores për Caktimin e Përkohshëm të Këshillit. 3. Një lëvizje e dyfishtë e prokurorit. U rikujton anëtarëve që, mbledhjet informale të Këshillit kanë për qëllim që nga diskutimet aty, anëtarët të kenë një qasje dhe jo në mbledhjen plenare. Për sa i përket caktimit të mësipërm, vlerëson që, nuk ka asnjë shkelje ligjore ndërsa ndryshimi në Rregullore, do të jetë një proces i gjatë dhe do të kërkonte kohë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Ibrahim i kalon fjalën znj. Seiti.

Znj. Seiti mendon se, në këtë logjikë po orientohet që Këshilli të shkelë ligjin, me qëllim plotësimin e një vendi. Ndërkohë që Këshilli duhet të marrë vendime ku të gjithë anëtarët të bien dakord parimisht dhe jo për interesa kohore, të kalohet nga një magjistrat nga Shkalla e Parë, në atë të Apelit. Sipas znj. Seiti, ky variant nuk duhej të ofrohej si propozim në Këshill. Insiston që prokurorja në fjalë, nuk i plotëson kushtet.

Z. Balla i shtron pyetjen znj. Seiti, nëse ka ndonjë propozim konkret.

Znj. Seiti përgjigjet që nuk ka dhe insiston që prokuroret të qëndrojnë në pozicionet aktuale.



Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projekt vendimit të parë.

Miratohet me 10 vota pro, kundër z. Cani (i pranishëm në votim dhe z. Staka)

Z. Ibrahim vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt vendimit për caktimin e përkohshëm të një prokurori në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.*

Meqënëse, z. Beci relatoi hollësisht në pikën e mësipërme të rendit të ditës, ku përfshihej dhe pika e katërt e rendit të ditës (caktimi i përkohshëm i znj. Ollga Visi në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Korçë), z. Ibrahim pasi lexoi vendimin, ia shtron Këshillit për miratim.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit të dytë.

Miratohet me 7 vota pro, 3 vota kundër z. Cani, z. Bazaj dhe znj. Seiti. Mungon z. Sheshi, i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Znj. Seiti sqaron votën e saj kundër, me argumentin se, është dakord për caktimin e znj. Visi si prokurore pranë Gjykatës së Apelit, por jo në pozicionin e Drejtuesit të saj.

Z. Ibrahim vijon me pikën e pestë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektvendimit për caktimin e përkohshëm të prokurorit Julian Çafka në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër.*

Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Staka të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Staka relaton projektvendimin e përgatitur nga ky Komision për prokurorin Julian Çafka. Citon bazën ligjore ku ky Komision është mbështetur: neni 62,42, paragrafi 2, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar. Thekson që, ky prokuror ka shprehur dëshirën për të hequr dorë nga pozicioni i Drejtuesit, por Komisioni e ka vlerësuar si të pamundur këtë kërkesë. Në këto kushte, Komisioni i kërkon Këshillit ta miratojë projektvendimin.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projekt vendimit.

Miratohet me 10 vota pro. Mungon z. Sheshi i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Z. Ibrahim vijon me pikën e gjashtë të rendit të ditës.



- *Miratimin e projekt vendimit për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm të prokurorit Françesk Ganaj si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.*

Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Dollapaj, të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Dollapaj relatton projektvendimin për z. Françesk Ganaj. Komisioni vlerëson që, me caktimin e një magjistrati në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Pukë, situata aty nuk është më alarmante. Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit që prokurori Ganaj ti ndërpritet caktimi i përkohshëm dhe kthimin e tij pranë Prokurorisë së rrethit Lezhë, duke patur parasysh dhe nevojat që ka kjo prokurori aty ku ai e ka dhe emërimin. Komisioni i kërkon Këshillit që ta miratojë atë.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projekt vendimit.

Miratohet me 10 vota pro. Mungon z. Sheshi i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Z. Ibrahim vijon me pikën e shtatë të rendit të ditës.

- *Prezantimin e opinioneve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për t'u komanduar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. (Kabineti i Inspektorit).*

Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Staka të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Staka relatton për opinionin që ky Komision ka përgatitur për njërin prej dy kandidatëve, znj. Mirela Kapo, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë. Mbështetur në, nenin 53, paragrafi 2, nenet 54, 55, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, (01.02.2020), Këshilli ka shpallur hapjen procedurave për paraqitjen e kërkesave nga kandidatët që vijnë nga rradhët e prokurorëve, për tu komanduar me pëlqimin e tyre për pozicionin e inspektorit pranë ILD-së. Në zbatim të ligjit të sipërcituar, nenit 54/4, Komisioni ka përgatitur një projektopinion për çdo kandidat dhe vlerëson, nëse komandimi është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Komisioni pasi ka bërë verifikimet përkatëse, si dhe bazuar në shkresën e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, e cila shprehet se, komandimi i znj. Kapo nuk çënon interesat e kësaj prokurorie, vlerëson që ky opinion është pozitiv, dhe i propozon Këshillit vijimin e procedurave të komandimit për këtë kandidaturë.



Z. Ibrahim shprehet se, nuk ka asnjë pengesë ligjore, opinionin është pozitiv, hedh në votim vijimin e procedurës së komandimit për znj. Kapo si kandidaturë që plotëson kriteret për tu komanduar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. (Kabineti i Inspektorit).

Miratohet me 10 vota pro, mungon z. Sheshi i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Z. Staka relacionon opinionin për kandidaturën e z. Julian Zonja, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Komisioni vlerëson që, bazuar në kthim përgjigjen e ardhur nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, ku argumenton se, për shkak të ngarkesës së madhe në punë, komandimi i z. Zonja, do të dëmtonte interesat aktuale të prokurorisë në fjalë. Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit, përjashtimin e tij nga komandimi.

Znj Seiti shpjegon se, znj. Kapo dhe z. Zonja kandidojnë për pjesë të ngushtë të kabinetit të ILD, prandaj është e rëndësishme që të bëhet dallimi mes kandidatëve që do të jenë këshilltarë dhe atyre që do të konkurojnë për pozicionin “inspektor” pranë ILD-së. Znj. Seiti u shpreh se, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës duhej t’i parashtronte Këshillit opinionet për kandidatët dhe jo ta përjashtonte dhe t’ia hiqte këtë të drejtë kandidatit. Ishte detyrë e Këshillit më pas të që të vendoste se cila prej tyre do të përzgjidhej.

Z. Dollapaj sqaron se, ligji e parashikon që edhe në ILD, një prokuror mund të komandohet jashtë pozicionit të inspektorit, sepse ka dispozitë të veçantë për pozicionin “inspektor”, dhe Këshilli e ka hapur garën për këtë pozicion. Siç e ngriti shqetësimin dhe z. Metani, arsyeja e kërkesës së komandimit të magjistrati ishte për shkak të mungesës së organikës deri sa të formohet ky institucion. Është një sakrificë, një magjistrat në pozicionin e këshilltarit në kabinet por për funksionimin sa më të shpejtë të kësaj zyre kjo kërkesë është pranuar. Sqaron dhe arsyen e përjashtimit të z. Zonja, nuk kanë qënë arsye subjektive, por për shkak të ngarkesës së prokurorisë ku ai ushtron funksionin, si dhe çështjeve shumë të rëndësishme që ky prokuror ka në shqyrtim, gjë e bërë e ditur me shkresën zyrtare të Drejtueses së prokurorisë nga ai vjen. Thekson që, Komisioni nuk ka dalë me një vendim, por thjesht i propozon Këshillit. Vendimarrjen dhe miratimi i opinionit i takon Këshillit në këtë seancë.

Z. Ibrahim sqaron se, Drejtuesja e Prokurorisë së Tiranës, e ka lënë në gjykim të Këshillit se cili prej kandidatëve do të cënonte interesin me të lartë të prokurorisë, duke marrë parasysh ngarkesën e punës bërë prezente me shkrim nga ana e kësaj Drejtuese.

Z. Beci shprehet se, Komisioni në vendimin e tij, i është referuar shkresës së sipërcituar, ku citohet arsyet që kandidatura e z. Zonja do të ndikonte në ecurinë e punës në atë prokurori.

Z. Balla falenderon z. Beci për informacionin e dhënë, por gjithësesi mendon që, Komisioni ka bërë gabim që e ka përjashtuar këtë kandidaturë, sepse dhe arsyeja që jep Drejtuesja nuk është e qartë.



Z. Cani i shtron pyetjen Komisionit që: Përse nga kandidaturat e paraqitura, vetëm ajo e znj. Kapo është pranuar? I kërkon këtij Komisioni se mbi cilat kritere ai u mbështet? Insiston që, arsyeja nuk lidhet vetëm me numrin e dosjeve në Prokurorinë e Tiranës, nuk e sheh bindëse. Thekson që, Këshilli duhet të tregohet i kujdesshëm në efektet e vendimeve që ai merr, kjo në respekt të të gjithë trupës së prokurorëve.

Z. Beluri vlerëson shumë të rëndësishme opinionin e Drejtuesit të Prokurorisë nga të cilët vijnë kandidatët. Shprehet që, për të pasur një opinion sa më të qartë, duhet që Drejtuesja në fjalë, ti parashtrojë më qartë arsyet që kandidatura e z. Zonja, çënon interesin më të lartë të prokurorisë. Cilido qoftë vlerësimi i Këshillit do të ishte subjektiv dhe i keqinterpretuar.

Z. Ibrahim u shpreh se, përgjigja nga ana e Drejtueses së Prokurorisë së Tiranës, duhej të ishte më e qartë, nuk është paraqitur bindshëm arsyetimi për z. Zonja, prandaj i kërkon Këshillit ta gykojë këtë kandidaturë. Ndryshe është rasti i Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili shprehet bindshëm që kandidatura e znj. Kapo nuk çënon në ecurinë e punës në këtë prokurori. Në këto kushte, argumenton që, vendimi i Komisionit është i arsyeshëm.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e propozimit për mosvazhdimin e procedurave të komandimit për z. Zonja.

Miratohet me 8 vota pro. Kundër znj. Seiti dhe z. Balla, mungon z. Sheshi i cili nuk është i pranishëm në sallë në këtë moment.

Z. Ibrahim vijon me pikën e tetë të rendit të ditës.

- *Prezantimin e opinioneve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për t'u komanduar në pozicionin Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*

Z. Ibrahim bën më dije që, afati i komandimit për 6 prokurorët të cilët kanë punuar pranë Këshillit, ka përfunduar. Në këto kushte, shtrohet nevoja për zgjatjen e këtij afati dhe Këshilli ka marrë një numër kandidaturash, për të cilat do të relatojë Komisioni Për Zhvillimin e Karrierës.

Z. Balla i kërkon Komisionit të relatojë vetëm për rastet problematike.

Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Beci të relatojë në emër të Komisionit të sipërcituar.

Z. Beci relaton në mënyrë të përmbledhur relacionet për 12 kandidatët, 5 prej tyre janë magjistratë të cilët kanë punuar deri më tani pranë Këshillit, ndërsa 7 janë kandidatë të rinj. Z. Beci relaton problematikat për këto kandidatura, siç është rasti i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe Vlorë. Drejtuesi i kësaj prokurorie, në kthim përgjigjen drejtuar Këshillit, ka argumentuar se, nga 3 kandidaturat, ka miratuar vetëm një të një prej tyre (nuk çënon interesin më të lartë të prokurorisë). E njëjta situatë paraqitet dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Berat, të cilët ia lenë vendimin në vullnet të Këshillit.



Z. Beci përfundon relatimin dhe i propozon Këshillit të miratojë komandimin për një periudhë komandimi 3 vjeçare të 6 prokurorëve (duke filluar që nga dt 24.02.2020), të cilët kanë marrë një opinion pozitiv nga Komisioni.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Znj. Seiti falenderon Komisionin për punën e bërë. Shprehet se, Komisioni ka vepruar drejt që në logjikën e përzgjedhjes, ka vënë theksin tek përvoja dhe i referohet 6 prej kandidatëve të cilët e kanë ushtruar këtë detyrë dhe me parë më argumentin se, ata tashmë e kanë krijuar bazën e punës dhe është shumë e rëndësishme që procesi i punës që ka nisur, të ndiqet nga të njëjtët profesionistë.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e opinioneve të dymbëdhjetë kandidatëve dhe vijon me votimin e vendimeve të komandimit për 6 prokurorët të ciët kanë opinion pozitiv për të vazhduar procedurën e komandimit, konkretisht për: **Artur Cara, Vitjuna Mata, Mihallaq Bleta, Ornela Rumbullaku, Erion Pano dhe Arjan Muçaj.**

Miratohen me 10 vota pro opinionet, mungon z. Sheshi.

Miratohen me 10 vota pro vendimet e komandimit për gjashtë prokurorë si këshilltar pranë KLP-së., mungon z. Sheshi.

Z. Ibrahim vijon me pikën e nëntë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt vendimit për fillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë në sistemin e prokurorisë.*

Z. Ibrahim thekson që është një detyrë e Këshillit, të cilën Këshilli duhej ta kishte kryer prej kohësh vendimi i sotëm i hap rrugën Komisionit të Vlerësimit, që të fillojë punën për procesin e verifikimit.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektvendimit për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kancelarit në detyrë. Këshilli mbështetur në, nenin 149/a, gërma “e” të Kushtetutës, në nenet 70, 111, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë” 164/8, 166/2, 189/1 gërma a, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale vendosi: 1. Të kryejë verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë 2. të hartojë raporte të veçanta me rezultatet e deklarateve të pasurisë dhe vlerësimit të figurës së tyre. 3. Ngarkohet Komisioni i sipërcituar dhe njësia mbështetese e komiseve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për kryerjen e këtij procesi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.



Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro, mungon z. Sheshi.

Z. Ibrahimi vijon me pikën e dhjetë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt vendimit për fillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë shprehur interesin për t`u komanduar si inspektor në ILD.*

Z. Ibrahimi i kalon fjalën z. Beci të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci citon 6 emrat e kandidatëve të cilët kanë shprehur interes për pozicionin e sipërcituar, konkretisht: **Elena Pelushi, Xhevahir Lita, Daniela Sulaj, Sonila Muhametaj (Domi), Lindita Ziguri dhe Julian Zonja.**

Z. Ibrahimi sqaron se, kjo procedurë komandimi ka një veçanti, sepse vihet në lëvizje vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit të figurës dhe pasurisë së kandidatit nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projektvendimit për fillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë shprehur interesin për t`u komanduar si inspektor në ILD.

Miratohet me 10 vota pro, mungon z. Sheshi.

Z. Ibrahimi vijon me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt vendimit për shtyrjen e afatit të aplikimit për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve vakante si prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (këtej e tutje Prokuroria e Posaçme).*

Z. Ibrahimi i kujton Këshillit Vendimin nr. 19, dt 27/01/2020, ku është parashikuar një afat 15 ditor për pritjen e shprehjes së interesit për pozicionin e sipërcituar dhe bën me dije se, numri i kandidatëve të ofruar nuk ishte i mjaftueshëm. Në këto kushte, propozon që të bëhet një ndryshim në pikën 3 të këtij vendimi, ku shprehet se afati i aplikimit është “jo më vonë se 15 ditë”, të zëvendësohet me “jo më vonë se 40 ditë”, edhe pse vlerësohet një afat i gjatë.

Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e këtij propozimi.

Miratohet me 10 vota pro, mungon z. Sheshi.

Z. Ibrahimi vijon me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.



- *Miratimin e projekt vendimit për fillimin e procedurave të komandimit të një magjistrati prokuror pranë EUROJUST për një periudhë 30 mujore.*

Z. Ibrahimi sqaron se, në vijim të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes “Për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it” e cila parashikon që të caktohet një prokuror i cili do të jetë ura lidhëse për zbatimin e kësaj marrëveshje, Prokurori i Përgjithshëm si autoritetit përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes, i është drejtuar Këshillit nëpërmjet një shkrese që, të fillojë procedurat për caktimin e përkohshëm të një prokurori pranë EUROJUST-it. Z. Ibrahimi, lexon projektvendimin. Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, neni 184 të ligjit nr.115/2016 “ Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 5 të ligjit për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin mes Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST, neneve 53 dhe 54 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, Këshilli vendosi të shpallë procedurat për fillimin e procedurave për komandimin e një një magjistrati pranë EUROJUST-it, për një periudhë 30 mujore. Ftohen të gjithë prokurorët që i plotësojnë kushtet të shprehin interesin, jo më vonë se dy javë nga njoftimi.

Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Dollapaj shprehet se, nuk duhet të jetë kusht që ky prokuror të ketë kaluar procesin e vetingut, nuk është një parashikim ligjor, me argumentin që ky kriter i kushtëzon ata.(kufizon kandidaturat)

Znj. Seiti shprehet se, lidhur me statusin që gëzon prokurori në momentit kur konkuron, të mos përjashtohen nga konkurimi kandidatët me status caktim i përkohshëm ose që janë të komanduar, duke u shprehur se pothuajse 80% e prokurorëve, janë më këtë status. Në këtë mënyre i ndërpritet mundësia një numri të konsiderueshëm prokurorësh në sistem.

Z. Balla kujton që ky problem është diskutuar në mbledhjen informale të Këshillit.

Z. Cani e vlerëson komandimin e një magjistrati pranë EUROJUST-it. Propozon që: 1. Ky magjistrat duhet të ketë kaluar procesin e vetingut, 2. Të hiqet kriteri i “caktimi i përkohshëm”, sepse nëpërmjet komandimit, në këtë rast bëhet fjalë për një prokuror që po ngrihet në detyrë.

Z. Ibrahimi sqaron se, nuk bëhet fjalë për caktimin e përkohshëm, por për ato ndalesa që parashikon ligji për sa i përket komandimit në momentin kur kandidon përsëri për një pozicion me procedurë komandimi. (ky është një ndalim që e parashikon ligji për statusin, në nenet përkatëse të komandimit, konkretisht neni 53).

Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projektvendimit.



Miratohet me 8 vota pro. Z. Dollapaj kundër duke argumentuar votën kundër për mosdakortësi me pikën e dytë të kriterëve.

Mungon z. Sheshi.

Z. Ibrahimi vijon me pikën e fundit të rendit të ditës.

- Hedhjen e shortit për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të cilët do të jenë pjesë e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, bazuar në nenin 11 të Rregullores).

Z. Ibrahimi fton një përfaqësuese nga administrata që të hedhë shortin. U hodhën dy shorte. Shorti i parë midis z. Cani, z. Sheshi, dhe shorti i dytë, midis znj. Seiti, z. Bazaj dhe z. Ibrahimi. Në përfundim të procesit, u zgjodhën z. Bazaj dhe z. Cani.

Z. Ibrahimi vijon me pikën që u përfshi në rend të ditës.

Z. Ibrahimi hedh në votim propozimin për ndryshimin e togfjalëshit që u propozua në këtë pikë.

Miratohet me 10 vota pro, mungon z. Sheshi.

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



KRYETARI

Gent Ibrahimi

Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___/___/2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___/___/2020 (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve) Procesverbalit i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë ___/___/2020

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

